

VENDIM
Nr.978, datë 2.7.2008

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA ARMO, SHA-JA, TIRANË, BASHKISË URA VAJGURORE TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL, TË DEGËS SË SHPËRNDARJES SË KARBURANTEVE, URA VAJGURORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.208, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO, SHA-SË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga ARMO, sh.a.-ja, Tiranë, bashkisë Ura Vajgurore të një sipërfaqeje 3 234 (tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër) m², truall, në zonën kadastrale 3682, me nr. pasurie 3/1, të degës së shpërndarjes së karburanteve, Ura Vajgurore, për ndërtimin e shkollës së mesme.
2. Në nr.36 të listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO, sh.a.-së”, të bëhet ndryshimi përkatës.
3. Ky ndryshim të reflektohet edhe në vendimin nr.720, datë 30.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Ura Vajgurore, të qarkut të Beratit”.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ARMO, sh.a.-ja, bashkia Ura Vajgurore dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VENDOSJES SE SHKOLLES SE MESME LASHNATORI

URE VADGURORE

SH: 1:500

SUPERFACIA = 3234 M² TEUNAK

TOPOGRAF
GURI NETAJ
BERAT ALB:
T. Z. 013

URE VADGURORE

MIRATONET:

KRYETAR BASHKIE
(AGIM BEGGU)

[Signature]

PRIME

REKLA

GURU BASHKIE

PSETI-URBANIS
ING. Thoma RUMNISI
[Signature]

